

Strategjitë e INSPIRE për të Ndaluar Dhunën Ndaj Fëmijëve

RAPORT

KOSOVA



HYRJA

Ky raport është i bazuar në të dhënat dhe vëzhgimet e shtatë organizatave që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë. Ndërsa pyetësi është ndarë përmes Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, kështu që organizatat që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim, janë anëtare të KOMF. Aktualisht nuk ekziston ndonjë grup punues nën platformën INSPIRE në Kosovë dhe strategjitë INSPIRE janë relativisht të panjohura brenda komunitetit të OJQ-ve.

Sidoqoftë, organizatat që morën pjesë në plotësimin e pyetësorit, punojnë në fusha që lidhen drejtpërdrejt me një ose më shumë strategji të INSPIRE.

Numri i organizatave që punojnë në strategjitë e INSPIRE, në Kosovë

Rezultatet bazuar në informacionin e marrë nga organizatat që morën pjesë në plotësimin e pyetësorit INSPIRE të ChildPact

Strategjia 1: Implementimi i legjislacionit

6 organizata

Strategjia 2: Normat dhe vlerat (gjinore, sociale, komuniteti)

2 organizata

Strategjia 3: Ambiente të sigurta

3 organizata

Strategjia 4: Mbështetja e prindërve dhe kujdestarëve

4 organizata

Strategjia 5: Të ardhurat dhe fuqizimi ekonomik

0 organizata

Strategjia 6: Reagim dhe shërbime mbështetëse

2 organizata

Strategjia 7: Edukim dhe shkathhtësi për jetë

4 organizata

ASPKETET E NDËRLIDHURA

Seksioni më poshtë paraqet aspektet e ndërlidhura që janë relevante për të gjitha strategjitë INSPIRE. Shembuj të aktiviteteve që janë relevante për strategjitë e ndryshme do të përshkruhen veçmas në seksionin vijues.

MARDHËNIET NË MES SEKTORIT JOQEVERITAR DHE AUTORITETEVE SHTETËRORE

Sipas të anketuarve të pyetësorit, ekziston një nivel i caktuar bashkëpunimi dhe mbështetjeje që ofrohet nga autoritetet shtetërore në nivel qendror dhe lokal drejt sektorit joqeveritar në Kosovë. Sidoqoftë, duke marrë parasysh nevojën për të përmirësuar shërbimet, kjo mbështetje nuk është e mjaftueshme dhe nuk siguron një ofrim të qëndrueshëm dhe cilësor të shërbimit. Ndiham shtetërore duhet të jetë e rregullt, e strukturuar dhe konsistente në mënyrë që të forcojë ndërhyrjet e sektorit të shoqërisë civile në kuadër të Strategjive INSPIRE.

Disa shembuj të mbështetjes shtetërore janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe komunat në nivel lokal. Në raste të tilla, Ministrinë kanë rritur obligimin dhe mandatin e tyre për t'u përqëndruar më shumë të fëmijët dhe mirëqenia e tyre, në një mënyrë bashkëpunuese dhe të strukturuar me shoqërinë civile. Përmes kontratave specifike të nënshkruara ose memorandumëve mes ministrive dhe organizatave, ndërhyrja e tyre ka qenë më e fortë, e koordinuar dhe më e suksesshme. Organizatat janë mbështetur posaçërisht në objektet shkollore, por edhe në ofrimin e shërbimeve për kategoritë e tjera të fëmijëve në nevojë.

PARANDALIMI I ABUZIMIT DHE SHFRYTËZIMIT SEKSUAL

Disa OJQ që janë përgjigjur në pyetësor, punojnë në parandalimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, ndërsa të tjerët përqendrohen në fusha të tjera, siç është arsimi ose ofrimi i shërbimeve për rehabilitimin e fëmijëve viktimë të dhunës. OJQ-të që punojnë në këtë fushë, kryesisht përqendrohen në nismat e avokimit për parandalimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, trajnimin e fëmijëve, prindërve dhe komuniteteve për të identifikuar dhe raportuar abuzimin seksual dhe shfrytëzimin.

Ndërsa, në anën tjetër ka OJQ që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për rehabilitimin e fëmijëve në rrezik ose viktimë të shfrytëzimit seksual. Ndiham financiare e ofruar nga ministrinë për OJQ-të, për ofrimin e shërbimeve të tilla duket se nuk është e mjaftueshme në lidhje me koston e ofrimit të shërbimeve. Për më tepër, thirrjet për projekte krijojnë hapësirë kohore nga një thirrje në tjetrën, duke shkaktuar shkaputje të financimit dhe rrjedhimisht ndërprerje të ofrimit të shërbimeve. Nga ana tjetër, mbështetja komunale mbetet ad hoc dhe ndryshon nga komuna në komunë. Shumë qendra rezidenciale dhe qendra të kujdesit ditor që janë pjesë e sektorit joqeveritar përballen me siguri ekzistenciale për shkak të mungesës së qëndrueshmërisë financiare, duke rrezikuar mbylljen e këtyre shërbimeve. Fëmijët që përfitojnë nga shërbimet e sektorit joqeveritar janë të detyruar të kalojnë nga një formë e kujdesit në një formë tjetër, që përbën një shkelje serioze të të drejtave të fëmijëve dhe ka një ndikim negativ në shëndetin fizik dhe psikologjik të tyre.

Disa organizata që janë përgjigjur në pyetësor; Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve, Save the Children dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarëve të Torturës (QKRMT), përqendrohen në nismat e avokimit dhe hartimin e rekomandimeve kryesore për nivelin qendror dhe lokal për të përmirësuar situatën. Mjetet e monitorimit në nivel lokal dhe qendror shërbejnë për të vlerësuar situatën, përfshirë atë në fushën e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual dhe për të dalë me rekomandimet më të rëndësishme për institucionet dhe profesionistët. Për më tepër, të gjitha këto OJQ (të anketuarit) punojnë vazhdimisht për të përmirësuar dhe plotësuar politikën e tyre për mbrojtjen e fëmijëve dhe politikën për sigurinë e fëmijëve si dokumente bazë drejt mbrojtjes së fëmijëve.

Shembuj të praktikave

Një praktikë e mirë që vlen të përmendet nga sektori i shoqërisë civile në Kosovë është zbatimi i mjetit kombëtar të monitorimit: Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës.¹ Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës është një instrument i pavarur i krijuar bashkërisht nga ChildPact dhe World Vision që mat sistemin e mbrojtjes së fëmijëve të një vendi. Në Kosovë, Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës zbatohet nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF çdo dy vjet dhe është një mjet kombëtar monitorimi i cili mat përpjekjet e qeverisë për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e abuzimit, dhunës, neglizhencës, shfrytëzimit dhe trafikimit.²

Një praktikë tjetër e mirë nga sektori i OJQ-ve është implementimi dhe plotësimi i rregullt i politikave për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe trajnimi për mbrojtjen e fëmijëve.

STRATEGJITË INSPIRE

STRATEGJIA 1: IMPLEMENTIMI I LEGJISLACIONIT



Të anketuarit që janë përgjigjur në pyetësor punojnë kryesisht në adresimin e dhunës dhe ndëshkimit të fëmijëve nga prindërit, mësuesit dhe kujdestarët e tjerë. Kjo adresohet kryesisht përmes Ligjit të Familjes, Draft Kodit Civil, Ligjit për Dhunën në Familje, Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Sidoqoftë, një prej të anketuarve punon në monitorimin dhe përmirësimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

- Kodi Civil
- Ligji për Familjen
- Ligji për Dhunën në Familje
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve
- Kodi Penal
- Kodi i Procedurës Penale
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur

Për të gjitha ligjet e lartpërmendura të anketuarit punojnë në përmirësimin e zbatimit të këtyre ligjeve.

Një shembull i mirë i ndikimit të OJQ-ve në përmirësimin e legjislacionit në Kosovë është Ndalimi i ndëshkimit trupor me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve në çdo mjedis, në shtëpi dhe në familje, institucione arsimore, në institucione të kujdesit, zbatimin e ligjit dhe sistemin e drejtësisë dhe në mjediset e komunitetit.

¹<http://www.childpact.org/wp-content/uploads/2018/01/Child-Protection-Index-2.0.pdf>

²<http://www.childpact.org/2018/01/19/child-protection-index-2-0-launched-in-kosovo/>

STRATEGJIA 2: NORMAT DHE VLERAT (GJINORE, SOCIALE, KOMUNITETI)



Fusha kryesore ku OJQ-të janë duke e përqendruar punën e tyre në lidhje me normat dhe vlerat është mobilizimi i komunitetit që synon të ndryshojë perceptimin, të zvogëlojë normat e dëmshme dhe të rrisë vetëdijen për vlerat pozitive dhe konstruktive.

Në disa raste, mobilizimi i komunitetit ka për qëllim të mbështesë organizatat lokale që punojnë në këtë fushë, direkt me komunitetet. Për shembull, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve ka ndarë nënfinancime për 7 organizata lokale për të hartuar Rregulloren Komunale, Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve.

Qendra për Arsim e Kosovës ka ndarë nënfinancime për 10 organizata lokale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, ndërsa Save the Children mbështet OJQ-të me programe për ngritjen e vetëdijes dhe ngritjen e kapaciteteve për trajnimin e prindërve dhe profesionistëve.

STRATEGJIA 3: AMBIENTE TË SIGURTA



Organizatat joqeveritare kanë ndërhyrë kryesisht, sa i përket infrastrukturës së institucioneve që punojnë me fëmijë siç janë shkollat me qëllimin për t'i bërë këto ambiente më miqësore ndaj fëmijëve. Trajnime dhe aktivitete me fëmijë dhe të rinj janë realizuar për të promovuar tolerancën dhe paqen e dialogut mbi diversitetin.

- Ndryshimi i mjedisve shkollore dhe adaptimi i tyre për fëmijë
- Trajnimi i mësuesve dhe profesionistëve për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna
- Të mësuarit dhe edukimi i fëmijëve dhe të rinjve përmes aktiviteteve sportive

Për shembull, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve përmes Indeksit të Mbrojtjes së Fëmijës nxjerr në pah dhe adreson "ambientet ku po ushtrohet dhunë" me qëllim të zvogëlimit të dhunës dhe prodhimit të ambienteve më të sigurta.

Qendra për Arsim e Kosovës punon në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe miqësor për fëmijët në shkolla përmes shpërndarjes dhe zbatimit të Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar të Kosovës dhe krijimin e Grupeve të Ndërmjetësimit nga adoleshentët.

Save the Children punon brenda shkollave për t'i bërë mjediset më miqësore ndaj fëmijëve përmes ofrimit të trajnimeve për profesionistë. OFAP siguron këshillime me familjet strehuese për fëmijët pa kujdes prindëror, ndërsa QKRMT punon me komunitetet.

STRATEGJIA 4: MBËSHTETJA E PRINDËRVE DHE KUJDESTARËVE



OJQ-të që ofrojnë shërbime direkte siç janë shërbimet për fëmijët pa kujdes prindëror ose fëmijë me aftësi të kufizuara, gjithashtu punojnë në familje, komunitete dhe në mesin e profesionistëve / ofruesve të përkujdesjes, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre për mbështetje më të mirë, si dhe për të përmirësuar shërbimet e ofruara.

Disa nga të anketuarit në pyetësor gjithashtu punojnë në promovimin e prindërimit alternativ dhe sjelljes së kujdesit siç është disiplina pozitive. Për shembull, Save the Children në partneritet me organizatat lokale organizon trajnimin Disiplinë Pozitive në Prindërimin dhe Përgatitjen e Përditshme, HANDIKOS vazhdon të trajnojë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në parimet e Disiplinës Pozitive në Prindërimin e Përditshëm, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror mbështet familjet strehuese, dhe i trajnon ata për mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdes prindëror të vendosur në strehimin familjar. Ndërsa SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, përmes aktiviteteve të ndryshme psiko-sociale, edukative, shëndetësore dhe avokuese, siguron që fëmijët të kenë akses në shërbime esenciale, të cilat mbrojnë mirëqenien e tyre; SOS mbështet prindërit në ndërtimin e aftësive prindërore dhe pavarësinë e tyre duke siguruar që ata mbrojnë dhe kujdesen për mirëqenien e fëmijëve të tyre; SOS gjithashtu avokon që komuniteti të reagojë në situatat kur familja rrezikon të ndahet.

- Promovimi i programit të disiplinës pozitive në mes të prindërve dhe kujdestarëve
- Programe trajnimi për të rritur kapacitetet e kujdestarëve

STRATEGJIA 5: TË ARDHURAT DHE FUQIZIMI EKONOMIK



Vetëm disa nga të anketuarit siç janë SOS, OFAP, KRCT punojnë drejt të ardhurave dhe fuqizimit ekonomik kryesisht për të fuqizuar grupet e cënueshme, konkretisht fëmijët pa kujdes prindëror për t'i bërë ata të aftë për jetë në moshën e rritur.

Specifikisht, SOS dhe OFAP mbështesin fëmijët përmes formës së mbrojtjes gjysmë të pavarur.

- Mbikqyrja e formës së mbrojtjes gjysmë të pavarur
- Aktivitete mikrofinanciare për të iu mundësuar fëmijëve dhe të rinjëve të bëhen të pavarur

- Evente për mbledhjen e fondeve për të siguruar kujdes të qëndrueshëm dhe shërbime për fëmijët pa kujdes prindëror

STRATEGJIA 6: REAGIM DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE



Në përgjithësi, OJQ-të ofrojnë shërbime të këshillimit, mbrojtjes dhe rehabilitimit, si dhe plotësimin e nevojave të grupeve dhe komuniteteve në nevojë për të fuqizuar grupet e cënueshme dhe për të forcuar mbështetjen ndaj tyre.

Organizata “Save the Children” ka mbështetur organizatat për ofrimin e shërbimeve sociale për grupet e cënueshme që kanë nevojë për shërbime sociale dhe mbrojtje.

Organizata “Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët” siguron strehim për fëmijët në nevojë për mbrojtje (rrezik të ulët), ofron shërbime mjekësore / psikologjike dhe arsimim, rehabilitim dhe riintegrim të fëmijëve të vendosur aty, deri sa të bëhet bashkimi familjar ose alternativa të tjera.

Organizata “SOS Fshatrat e Fëmijëve” ofron strehim dhe shërbime sociale dhe psikologjike për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror ose viktimat e neglizhencës dhe abuzimit.

OFAP punon në fushën specifike të strehimit familjar për të zhvilluar një sistem të strehimit familjar për fëmijët pa kujdes prindëror.

- Shërbime psikologjike dhe pedagogjike
- Këshillim për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre

STRATEGJIA 7: EDUKIM DHE SHKATHTËSI PËR JETË



Organizatat që iu përgjigjën pyetësorit janë të përqendruara kryesisht në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe përmirësimin e njohurive në mes grupeve të cënueshme. Vëmendje i kushtohet rritjes së kapaciteteve dhe ngritjes së aftësive jetësore, si dhe rritjes së regjistrimit në edukimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.

- Program për aftësi jetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara
- Programi i trajnimit për menaxhimin e zemërimit dhe marrjen e vendimeve për fëmijët në mjedisin arsimor / korrektues

SOS dhe OFAP ofrojnë trajnime dhe edukim mbi aftësitë e jetës.

QKRMT investon në trajnimin e aftësive shoqërore dhe jetësore. Nën aksionin e Komitetit Holandez të Helsinkit, QKRMT ndërton kapacitete të institucionit korrektues për të prezantuar konceptet dhe për të ofruar trajnime për të miturit nën aftësitë e komunikimit dhe vendimmarrjes, aftësive sociale, menaxhimit të zemërimit etj.

VEGËZA DHE REFERENCA

Tabela më poshtë përfshin listën e plotë të organizatave që iu përgjigjën pyetësorit dhe iu referuan aktiviteteve që lidhen me INSPIRE, si dhe linqet e web-faqeve të tyre, dhe liqet e disa iniciativave specifike që janë relevante.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF - <http://www.komfkosova.org>

Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror - <http://ofap-ks.org>

HANDIKOS - <http://www.handi-kos.org>

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarëve të Torturës (QKRMT) - <http://www.krct.org>

Play International - <https://pl4y.international/fr>

Save the Children in Kosovo - <https://kosovo.savethechildren.net>

SOS Fshtratrat e Fëmijëve në Kosovë - <https://www.sos-childrensvillages.org/where-we-help/europe/kosovo>

NË LIDHJE ME KËTË RAPORT

Ky raport është prodhuar nga ChildPact dhe Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF, në kuadër të dy projekteve rajonale të financuara nga Oak Foundation dhe INSPIRE Fund. Të dy projektet përfshijnë nisma plotësuese për të hartuar aktivitetet që aktualisht janë duke u realizuar në përputhje me kornizën INSPIRE në rajonin e zgjeruar të Detit të Zi me qëllim të kuptimit më të mirë të përpjekjeve aktuale dhe përmirësimit të sinergjive midis aktorëve ekzistues që punojnë në zbatimin e strategjive INSPIRE.

Të dhënat u mbledhën në mes të muajit prill dhe korrik 2019. Pyetësori rajonal është në dispozicion në gjuhën angleze në këtë [link](#).



Ne dëshirojmë të falënderojmë të gjitha organizatat që kanë marrë pjesë në këtë pyetësor të rëndësishëm rajonal përgjatë muajve të fundit.

Hartuar nga: Loreta Keqekolla, Zyrtare për Avokim/Komunikim – KOMF
Redaktuar nga: Klevis Vaqari, Menaxhere e Programit – KOMF